

VENDIM
Nr. 216, datë 11.10.2018

MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” SHA (OSHEE SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 96, DATË 27.10.2014, TE SHOQËRIA “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SHA (OSSH SHA), E VLEFSHME DERI NË DATËN 27.10.2044
(ndryshuar me vendimin nr. 224, datë 9.11.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 37, pika 2, germa “c”, si dhe të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “c”; të nenit 5, pika 1, germa “c”; të nenit 13 dhe të nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi transferimin e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë në ERE dokumentacionin për transferimin e licencave/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.).

- Shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.) është themeluar me statusin e shoqërisë aksionare në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 4.6.2018, vendosi të fillojë procedurën për transferim e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044, të shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.).

- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar, ERE, në zbatim të nenit 10, pikat 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, me shkresën nr. 55/36 prot., datë 13.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar lidhur me kërkesën e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të rregullores sipërcituar, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, dhe mban licencën me nr. 250, seria P14SH.

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE, me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, “Përcillet dokumentacioni ...”, “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” (OSHEE sh.a.), ndër të tjera bën me dije, se” “Transferimi i personelit për këtë shoqëri, “Operatori i sistemit të shpërndarjes” (OSSH sh.a.), është në proces. Për rrjedhojë, lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, do të plotësohet në vijim”.

- Me shkresën nr. 355/5 prot. datë 9.8.2018, ERE i ka kërkuar aplikuesit plotësim dokumentacioni dhe, me shkresën e datës 3.9.2018, protokolluar me tonën nr. 355/6 prot., “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a.) ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për llogari të shoqërisë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” (OSSH sh.a.).

- Aplikimi i shoqërisë OSSH sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në bazë të nenit 10, pika 1 dhe 2, si dhe të nenit 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa “d” (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike). Diagrami i sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektives: subjekti nuk deklaron që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.

- Neni 17, pika 4, germa “a” (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës në operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, të shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri në datën 27.10.2044.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti